
	<p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.03.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Samire Osmani B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, Autoriteti Publik – Komuna e Prishtinës me datë: 09.03.2023 nxjerr:

V E N D I M

1. **Hudhet poshtë si e palejuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: Samire Osmani B.I. e parashtruar me datë: 08.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës 10.02.2022 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. **Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesë për rishqyrtim të ngjashme të OE ankimor me datë: 01.03.2023 dhe ka ngritur në platformë elektronike E-Prokurimi sqarimet për të gjitha pretendimet 24.02.2023. Autoriteti Publik ka bërë ndryshimet në dosje të tenderit konform kërkesave për pjesëmarrje për të gjithë ofertuesit duke respektuar parimin e konkurrencës së lirë.**
3. **Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1.**
4. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit

Palës përmes sistemit elektronik – E-Prokurimi

Arkivit

Visar Shehu – U.D. – Departamenti i Prokurimit

